

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

RAPORTI I MBIKËQYRJES


SUPERVISION REPORT

**2016**

TREGU I SIGURIMEVE, I FONDEVE TË PENSIONEVE VULLNETARE, I FONDEVE TË INVESTIMEVE  
INSURANCE, VOLUNTARY PENSIONS FUNDS, INVESTMENTS FUNDS MARKET

## PËRMBAJTJA


<b>I.</b>	<b>Misioni i Mbikëqyrjes</b>	<b>5</b>
<b>II.</b>	<b>Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve</b>	<b>6</b>
	1. Struktura e Tregut të Sigurimeve	6
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	6
	3. Analiza e Ecurisë dhe Rreziqeve të Tregut të Sigurimeve	8
<b>III.</b>	<b>Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare</b>	<b>13</b>
	1. Struktura e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	13
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	14
	3. Treguesit Teknikë e Financiarë të Shoqërive Administruese dhe Fondeve të Pensioneve Vullnetare	15
<b>IV</b>	<b>Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve</b>	<b>16</b>
	1. Struktura e Tregut të Fondeve të Investimeve	16
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Investimeve	18
	3. Treguesit Kryesorë të Tregut të Fondeve të Investimeve 31.12.2016	
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>21</b>
	1. Tregu i Sigurimeve	21
	2. Tregu i Fondeve të Pensioneve Private Vullnetare	68
	3. Tregu i Fondeve të Investimeve	82



## CONTENTS

<b>I.</b>	<b>Supervision Mission</b>	<b>5</b>
<b>II.</b>	<b>Report on the Financial Situation of the Insurance Market</b>	<b>6</b>
1.	Insurance Market Structure	6
2.	Insurance Market Supervision	6
3.	Analysis of the Performance and Risks of the Insurance Market	8
<b>III.</b>	<b>Report on the Financial Situation of the Voluntary Private Pension Market</b>	<b>13</b>
1.	Structure of Voluntary Private Pension Market	13
2.	Voluntary Private Pension Market Supervision	14
3.	Technical and Financial Indicators of the Management Companies and Voluntary Pension Funds	15
<b>IV</b>	<b>Report on the Financial Situation of the Investment Fund Market</b>	<b>16</b>
1.	Structure of the Investment Fund Market	16
2.	Supervision of the Investment Fund Market	18
3.	The Main Indicators of the Investment Fund Market 31.12.2016	
<b>V.</b>	<b>ANNEXES</b>	<b>21</b>
1.	Insurance Market	21
2.	Voluntary Private Pension Fund Market	68
3.	Investment Fund Market	82





## I. Misioni i Mbikëqyrjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregjeve financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare në Shqipëri. AMF i ushtron funksionet mbikëqyrëse mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2014. Ndryshimet dhe shtesat në këtë ligj synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së në përmbushje të objektivave, nëpërmjet forcimit të pavarësisë dhe të përgjegjshmërisë së tij.

Misioni themelor i AMF-së, në zbatim të përgjegjësiave ligjore si autoritet mbikëqyrës, është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore në fuqi.

Tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së janë zgjeruar në vijimësi. Në vitin 2016, totali i aktiveve në këto tregje arriti në rreth 96.4 miliardë lekë. Pesha që zënë aktivet e tregut të sigurimeve në raport me tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së është rritur nga 28.85% në 30.79%, në fund të vitit 2016. Totali i aktiveve në tregun e sigurimeve është rritur me 7.53%, krahasuar me vitin 2015, ose në vlerë nominale nga rreth 27.6 miliardë lekë që ka qenë në vitin 2015, në rreth 29.7 miliardë lekë në 31.12.2016. Treguesi i aktiveve gjithsej ndaj PBB-së, që shpreh kontributin e këtyre tregjeve në ndërmjetësimin financiar, arriti në nivelin 6.51%.

Edhe në vijim, AMF do të realizojë misionin e tij, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane, bashkërendimit të analizës së dokumentacionit financiar dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit të procesit të mbikëqyrjes drejt asaj me Fokun Rreziku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, trajnimit të stafit drejt një mbikëqyrjeje efektive, etj.

## I. Supervision Mission

*The Albanian Financial Supervisory Authority (AFSA) is the integrated regulatory and supervisory authority of the financial markets of insurance, securities and voluntary private pensions in Albania. The AFSA exercises supervisory functions based on Law no. 9572 dated 03.07.2006 “On the Financial Supervisory Authority”, as amended by Law no. 54/2014. Amendments and addition to this law aim at strengthening the regulatory and supervisory role of AFSA in fulfilling its objectives by strengthening its independence and accountability.*

*The fundamental mission of AFSA, pursuant to legal responsibilities as the supervisory authority is to protect the interests of consumers and investors, closely associated with the security of supervised guaranteeing the fulfilment of the applicable legal provisions.*

*Markets under the supervision of AFSA have been continuously expanded. In 2016, the total assets in these markets amounted to about ALL 96.4 billion. The share of assets of the insurance market compared to markets under the supervision of AFSA increased from 28.85% to 30.79%, at the end of 2016. Total assets of the insurance market grew by 7.53%, compared to year 2015, or at the nominal value of ALL 27.6 billion in 2015 to about ALL 29.7 billion on 31.12.2016. The total assets Indicator of GDP, which shows the contribution of these markets in financial intermediation, reached the level of 6.51%.*

*In the future, AFSA will further accomplish its supervisory mission, through continuous improvement of regulatory and supervisory framework in line with international principles and European directives, coordinating the analysis of financial documentation with the supervision of market in place, orientation of the supervision process to risk-focused supervision, undertaking market development policies and training of staff towards an effective supervision, etc.*

## II. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve

### 1. Struktura e tregut të sigurimeve

Tregu i sigurimeve në 31.12.2016 përbëhet nga 10 shoqëri që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë fushë. Në strukturën e tregut, shtatë shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimin Jo-Jetë, dy në sigurimin e Jetës, një shoqëri kompozite e Jetës dhe Jo-Jetës. Një nga shoqëritë e Jo-Jetës kryen edhe aktivitetet risigurimi. Bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, edhe gjatë këtij viti vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga portofoli i MTPL-së së brendshme që në 31.12.2016, zënë rreth 66% të primeve të shkruara bruto.

### 2. Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve

Tregu i sigurimeve vijon me një ritëm relativisht të qëndrueshëm zgjerimi, me total aktivesh që luhet në intervalin 1.3%-1.92% e PBB-së për periudhën 2005-2015 dhe 2.01% e PBB-së në vitin 2016. Zgjerimi ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto, kryesisht në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Pavarësisht këtij zgjerimi të tregut të sigurimeve, pesha e tij në tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF, është në nivele afërsisht të njëjta, përkatësisht 30.0%, 27.4%, 29.1% dhe 30.79% për vitet 2013-2016. AMF, si autoritet mbikëqyrës e rregullator për tregjet financiare të sigurimeve, ka për mision të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare. Kjo dikton nevojën e:

- Vijimit të zbatimit të masave stabilizuese në tregun e sigurimeve dhe vendosjes së standardeve të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, si dhe zbatimin e mbikëqyrjes me Fokus Rrezikun;
- Forcimin e rregullave të administrimit të rrezikut në harmoni me evoluimin e rregullave të përshkruara në Direktivat përkatëse të BE-së, duke mbikëqyruar respektimin e regjimit të informimit, mjaftueshmërisë së kapitalit, niveleve të likuiditetit, si dhe vlerësimin real të aktiveve.

Gjatë vitit 2016, tregu shqiptar i sigurimeve pati një rritje të ndjeshme nga pikëpamja e vëllimit total të primeve të shkruara bruto, të cilat arritën shifrën 15.37 miliardë lekë, duke u rritur afërsisht me 9.1%, krahasuar me vitin 2015. Nga pikëpamja e numrit të shoqërive operuese në këtë treg, gjatë vitit 2016, nuk pati ndryshime.

Në strukturë, tregu vazhdoi të mbetet i orientuar tek sigurimet Jo-Jetë, të cilat sollën rreth 93.60% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, sollën 6.4% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë vitit 2016, sigurimet vullnetare zunë 33.9% dhe ato të detyrueshme zunë 66.10% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve. Në zbatim të koadrit rregullator ekzistues, edhe gjatë vitit 2016, AMF ka mbikëqyruar dhe

## II. Report on the Financial Situation of the Insurance Market

### 1. Insurance market structure

The insurance market on 31.12.2016 consisted of 10 companies operating their activity in this area. In the market structure, seven insurance companies operate their activities in the Non-Life insurance, two in the Life insurance and mixed Life and Non-Life insurance. One of the Non-Life insurance companies operates in the reinsurance market as well. Based on the 'Technical Account' statement of Non-Life insurance companies, it was also noted that even during this year, the insurance market continues to be dominated by domestic MTPL portfolio that on 31.12.2016, consisted of approximately 66% of gross written premiums.


### 2. Insurance market supervision

The insurance market continues at a relatively stable expansion rate, with total assets fluctuating in the range of 1.3% -1.92% of GDP for the period 2005-2015 and 2.01% of GDP in 2016. The expansion came as a result of increased volume of gross written premiums, mainly in products of compulsory motor insurance. Despite the expansion of the insurance market, its share in the financial markets supervised by AFSA remains roughly in the same levels, respectively 30.0%, 27.4%, 29.1% and 30.79% for the years 2013-2016. AFSA's mission, as the supervisory and regulatory authority of financial markets, is to contribute to the promotion of financial stability. This dictates the needs for:

- Continuous enforcement measures in the insurance market stabilization and the establishment of well-defined standards, regarding the minimum reserves and the implementation of risk-based supervision;
- Strengthening of risk management rules in harmony with the evolution of rules described in the relevant EU directive, by closely supervised respecting the information regime, solvency, liquidity levels, and real asset valuation.

During 2016, the Albanian insurance market grew sensitive, in terms of the total volume gross written premiums, which reached the figure of ALL 15.37 billion, increasing approximately 9.1%, compared with 2015. During 2016, there were no changes related to the number of companies operating in this market.

With regard to the structure, the market continued to be dominated by the Non-Life insurance, which share was about 93.60% of the total volume of gross written premiums, while life insurance was 6.4% of the total gross written premium volume. During 2016, market shares of voluntary and compulsory insurance were respectively 33.9% and 66.10% of the total gross written premiums. Pursuant to the existing regulatory framework, even in 2016, AFSA has



analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit. AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë së shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij.

Zhvillimi më i rëndësishëm me ndikim afatmesëm në tregun e sigurimit mbetet vazhdimësia e zbatimit nga AMF të Metodologjisë së Mbikëqyrjes me Fokus Rrezikun, duke pasur si synim forcimin e metodologjisë mbikëqyrëse për tregun e sigurimeve. Konkretisht, AMF realizoi inspektime në tre shoqëri sigurimi bazuar në këtë metodë mbikëqyrjeje. Ky proces do të zbatohet për të gjitha shoqëritë e sigurimeve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash në nivel tregu, e cila ndihmon në vlerësimin e rrezikut të secilës shoqëri sigurimi, brenda vitit 2017. Gjatë vitit 2016 janë kryer tre inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë, një inspektim tematik pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit me fokus Fondin e Kompensimit, si dhe një tjetër inspektim tematik me fokus parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, në një nga shoqëritë e sigurimit të Jetës. Gjithashtu, pranë të gjitha shoqërive të sigurimit është kryer dhe një inspektim i pa lajmëruar lidhur me tarifat e MTPL-së. Ajo që paraqet rëndësi është fakti që tashmë AMF ka në zbatim një paketë mbikëqyrjeje nëpërmjet së cilës është duke u përmirësuar procesi i vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve në kuadër të shoqërisë dhe të tregut në tërësi, duke rritur efektivitetin e procesit mbikëqyrës dhe marrjes së masave mbikëqyrëse.

Metodologjia e mbikëqyrjes me Fokus Rrezikun, synon hartimin e një profili rreziku për shoqërinë e sigurimit, i cili përfaqëson vlerësimin nga ana e autoritetit mbikëqyrës në lidhje me fushat e rreziqeve specifike të shoqërisë, brenda kontekstit të sektorit të sigurimeve. Pjesë e kësaj metodologjie janë dhe fazat e ndërhyrjes nga ana e autoritetit mbikëqyrës, gjatë niveleve të ndryshme të rrezikut, ndërhyrje e cila ndryshon në varësi të nivelit të rrezikut në një shoqëri sigurimi. Në kuadrin e zbatimit gradual të metodologjisë së re të mbikëqyrjes, AMF është duke punuar për zbatimin e një sistemi të treguesve të paralajmërimit të hershëm për tregun e sigurimit Jo-Jetë, i cili do të vendosë prioritetet dhe drejtojë burimet rregullatore drejt atyre siguruesve që paraqesin profil më të lartë rreziku.

Metodologjia e mbikëqyrjes me Fokus Rrezikun, përveçse mbështetet në legjislacionin aktual, i cili krijon hapësirat e nevojshme ligjore për zbatimin e kësaj metodologjie, mbështetet edhe në sistemin e raportimit AMF In-Reg, që është platforma dhe kanali kryesor i raportimit të subjekteve të mbikëqyrura nga AMF. Në plan afatgjatë, ky sistem do të shërbejë si platforma kryesore mbështetëse e mbikëqyrjes me Fokus Rrezikun. Me rëndësi të veçantë janë edhe kërkesat e ligjit për forcimin e qeverisjes së shoqërive të sigurimit, si dhe ushtrimin të mbikëqyrjes së grupeve. Për të dy këto elemente, por edhe për mjaft

*supervised and analyzed the insurance market, assessing the financial position, results and technical indicators of the insurance company's activity. AFSA constantly followed up the fulfillment of legal requirements regarding the guarantee fund of insurance companies and enforcement of rules on its investment.*

*The most important development with a medium-term impact on the insurance market remains the continuation of AFSA's implementation of Risk-Focused Supervision Methodology, aiming at strengthening the supervisory methodology for the insurance market. In specific terms, AFSA carried out inspections in three insurance companies based on this supervision method. This process will be applied to all insurance companies, thus creating a market-level database that helps to assess the risk of each insurance company by 2017. During 2016, three thematic inspections were conducted in Non-Life insurance companies, a thematic inspection at the Albanian Insurance Bureau focused on Compensation Fund, and another thematic inspection focused on the prevention of money laundering and terrorist financing, in cooperation with the General Directorate for the Prevention of Money Laundering, in one of life insurance companies. In addition, it was carried out an unannounced inspection of the MTPL tariffs at all insurance companies. It is rather important the fact that AFSA has already implemented a supervisory package through which it will improve the assessment process and risk-monitoring within the company and the market as a whole, by increasing the effectiveness of the supervisory process and taking supervisory measures.*

*The methodology of risk-based supervision aims to develop a risk profile for the insurance company, which represents the assessment by the supervisory authority related to the fields of specific risks to the company, within the context of the insurance sector. Parts of this methodology are also the stages of intervention by the supervisory authority over different levels of risk, an intervention, which varies depending on the level of risk in an insurance company. In the framework of the gradual implementation of the new supervisory methodology, the AFSA is working to establish an early warning system for Non-Life insurance market, which shall set priorities and conduct regulatory resources towards those providers that present a higher risk profile.*

*The methodology of risk-focused supervision is not only based on current legislation which creates the required legal space for the implementation of this new methodology, but it also relies on the AMF In-Reg reporting system, which is the platform and the main channel of reporting the entities supervised by AFSA. In the long term, this system shall serve as the primary supporting platform of risk-based supervision. Another innovation of the law includes the requirements for strengthening the governance of insurance companies, as well as performing the supervision of groups. For both these elements, but also for many other*

kërkesa të tjera që parashikon ligji, janë hartuar dhe po vijojnë të përgatiten një numër rregulloresh, të cilat do të plotësojnë kuadrin e nevojshëm për zbatimin e ligjit. Ndërkohë, gjatë vitit 2016 ka vazhduar përfshirja e AMF-së në kolegjet mbikëqyrëse të grupeve financiare austriake të pranishme në Shqipëri, pasi kapitali austriak në tregun e sigurimeve në Shqipëri ka një peshë të konsiderueshme. Tregu i sigurimeve në tërësinë e tij shfaq nevojën e ruajtjes së stabilitetit të mjaftueshmërisë së kapitalit, përmirësimit të raportit dëme/prime dhe rritjes së shkallës së penetrimit. Për rregullimin ligjor të tregut të sigurimeve, gjatë vitit 2016, u hartuan dhe u miratuan edhe rregulloret e tjera si më poshtë:

- Rregullore nr. 200, datë 27.12.2016 “Për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve”;
- Rregullore nr. 187, datë 24.11.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes së provigjoneve matematike, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike dhe kriteret e procedurat e miratimit të tyre”;
- Rregullore nr. 87, datë 27.06.2016 “Mbi elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit të shoqërive të sigurimit”;
- Rregullore nr. 76, datë 30.05.2016 “Mbi kategoritë e investimeve të lejuara, kufizimet që zbatohen dhe përdorimin e instrumenteve financiare derivative”;
- Rregullore nr. 57, datë 28.04.2016 “Mbi trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar”;
- Rregullore nr. 56, datë 28.04.2016 “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”;
- Rregullore nr. 40, datë 31.03.2016 “Mbi formën, përmbajtjen dhe rregullat për mbajtjen e regjistrave të ndërmjetësve në sigurime”;
- Rregullore nr. 38, datë 31.03.2016 “Për përmbajtjen, mënyrën, afatet e raportimit dhe njoftimit periodik në AMF nga shoqëritë e sigurimit”;
- Rregullore nr. 9, datë 25.01.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti”;
- Rregullore nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”;
- Rregullore nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”.

### 3. Analiza e ecurisë dhe rreziqeve të tregut të sigurimeve

Për vitin 2016, tregu i sigurimeve ka shfaqur një ecuri relativisht të mirë financiare në tërësi. Ecuria e treguesve financiarë, shfaqet si më poshtë:

- **Totali i primeve të shkruara bruto**, për tregun e sigurimeve në 31.12.2016 është rreth 15.4 miliardë

requirements provided by law, a set of regulations have been drafted and are continuing to be prepared, which will meet the required framework for the implementation of the law. Meanwhile, in 2016 continued the inclusion of the AFSA in the supervisory colleges of the Austrian financial groups present in Albania, as the Austrian capital in the insurance market in Albania has a considerable share. The insurance market in its entirety reveals the need for improvement in the ratio of claims/premiums and increase in the penetration level. For the legal regulation of the insurance market, during 2016, other regulations were drafted and approved as follows hereunder:


- Regulation no. 200, dated 27.12.2016 “On the assets covering the mathematical provisions and the types of allowed investments of these assets”;
- Regulation no. 187, dated 24.11.2016 “On the basis and methods of calculating mathematical provisions, the methods of keeping mathematical provisions and the criteria and procedures for their approval”;
- Regulation no. 87, dated 27.06.2016 “On deductible elements in the calculation of the capital of insurance companies”;
- Regulation no. 76, dated 30.05.2016 “On permitted investment categories, applicable restrictions and use of derivative financial instruments”;
- Regulation no. 57, dated 28.04.2016 “On continuous professional trainings and renewal of the authorized license of actuaries”;
- Regulation no. 56, dated 28.04.2016 “On liquidity management by insurance and reinsurance companies”;
- Regulation no. 40, dated 31.03.2016 “On the form, content and rules for keeping records of mediators in insurance”;
- Regulation no. 38, dated 31.03.2016 “On the content, method, timing of reporting and periodic notification to the AFSA by insurance companies”;
- Regulation no. 9, dated 25.01.2016 “On the basis and methods of calculation, the methods of keeping technical provisions, and the criteria and procedures for their approval by the Authority”;
- Regulation no. 2, dated 25.01.2016 “On the form, terms and content of financial statements, statistical reports and other reports of mediators in insurance and reinsurance”;
- Regulation no. 1, dated 25.01.2016 “On procedures and the method of delivering information and documentation related to the capital source for shareholders of insurance companies”.

### 3. Analysis of the performance and risks of the insurance market

In 2016, the insurance market has shown a relatively good financial performance in general. The performance of financial indicators were as follows:

- **Total gross written premiums** for the insurance market as of 31.12.2016 was approximately ALL 15.4 billion,





lekë, duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej 1.28 miliardë lekë, ose në masën 9.1%, në krahasim me vitin 2015, vit gjatë të cilit ka qenë rreth 14.1 miliardë lekë.


- Primet e shkruara bruto për tregun e sigurimit Jo-Jetë kanë arritur vlerën rreth 14.4 miliardë lekë, duke u rritur me rreth 1.3 miliardë lekë, ose 10.2%, në krahasim me fundin e vitit 2015, kur primet e shkruara bruto shënuan vlerën 13.1 miliardë lekë.
- Primet e shkruara bruto për tregun e sigurimit të Jetës në fund të vitit 2016 janë në vlerën 978.4 milionë lekë, duke shënuar një rënie me 49.6 milionë lekë ose 4.8%, në krahasim me vitin 2015, kur primet e shkruara bruto kanë qenë rreth 1.03 miliardë lekë.
- Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit për tregun e sigurimit Jo-Jetë në 31.12.2016 është 60.3%, duke qenë kështu nën nivelin minimal të kërkuar. Kapitali i shoqërive të tregut të sigurimit Jo-Jetë ka qenë në vlerën 2.2 miliardë lekë, duke u ulur me rreth 1 miliardë lekë, ose 32.3%, krahasuar me 31.12.2015, që ka qenë rreth 3.2 miliardë lekë. Në 31.12.2016, mjaftueshmëria e kapitalit për tregun e sigurimit Jo-Jetë ka rezultuar rreth 1.4 miliardë lekë nën nivelin e kërkuar, ndërkohë që në 31.12.2015 ka qenë rreth 263 milionë lekë nën nivelin e kërkuar. Për tregun e sigurimit të Jetës, ky tregues ka qenë 122.5%, duke qëndruar brenda kufijve të lejuar. Në 31.12.2016, kapitali i shoqërive të tregut të sigurimit të Jetës ka qenë në vlerën 1.36 miliardë lekë, duke u ulur me 310 milionë lekë, ose 18.6%, krahasuar me 31.12.2015, kur kapitali i shoqërive të sigurimit të Jetës ka qenë rreth 1.67 miliardë lekë. Në 31.12.2016, mjaftueshmëria e kapitalit për tregun e sigurimit të Jetës ka rezultuar rreth 249.5 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ndërkohë që në 31.12.2015 ka qenë rreth 560.2 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar.

marking a considerable increase of ALL 1.28 billion, or 9.1% in comparison with 2015, the year in which they were approximately ALL 14.1 billion.

- Gross written premiums for the Non-Life insurance market reached ALL 14.4 billion, increasing by about ALL 1.3 billion, or 10.2%, compared to the end of 2015, when gross written premiums amounted to ALL 13.1 billion.
- Gross written premiums for Life insurance market, at the end of 2016, were in the value of ALL 978.4 million, marking a decline of ALL 49.6 million or 4.8%, compared to 2015, when gross written premiums were about ALL 1.03 billion.
- Capital adequacy ratio for non-life insurance market on 31.12.2016 was 60.3%, being below the required minimum level. The capital of Non-Life insurance companies was ALL 2.2 billion, reduced by about ALL 1 billion, or 32.3%, compared to 31.12.2015, which was around ALL 3.2 billion. On 31.12.2016, capital adequacy for the Non-Life insurance market resulted in ALL 1.4 billion below the required level, while at 31.12.2015 it was about ALL 263 million below the required level. For Life insurance market, this indicator was 122.5%, remaining within the allowed limits. On 31.12.2016, the capital of Life insurance companies was ALL 1.36 billion, decreasing by ALL 310 million or 18.6% compared to 31 December 2015, when the capital of Life insurance companies was about ALL 1.67 billion. On 31.12.2016, the capital adequacy for the Life insurance market resulted around ALL 249.5 million above the required level, while on 31.12.2015 it was around ALL 560.2 million above the required level.


### Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit për Sigurimin Jo-Jetë

Capital Adequacy Indicator for Non-Life Insurance




### Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit për Sigurimin e Jetës

Capital Adequacy Indicator for Life Insurance



- Treguesi i Aktiveve në mbulim të Provigjoneve Teknike për tregun e sigurimeve për periudhën 31.12.2016 është në masën 96.27%, duke shënuar një rënie, nga 106.8% që ka qenë në 31.12.2015. Për periudhën 31.12.2016 ky tregues për tregun e sigurimit Jo-Jetë është 95.37%, duke rënë nga 104.56% që ka qenë në fund të vitit 2015, ndërsa për tregun e sigurimit të Jetës është 103.63%, duke rënë nga 124.18% që ka qenë në 31.12.2015.
- Treguesit e Rentabilitetit ROE dhe ROA për tregun e sigurimit Jo-Jetë janë përkatësisht në nivelin 5.08% (nga 4.2% në 31.12.2015) dhe 1.6% (nga 1.5% në 31.12.2015). Ndërsa për tregun e Jetës janë përkatësisht në nivelin 5.14% (nga 13.2% në 31.12.2015) dhe 2.4% (nga 6.1% në 31.12.2015). Treguesit ROE dhe ROA kanë pësuar një rritje në krahasim me vitin 2015 për tregun e sigurimit Jo-Jetë, ndërkohë që për tregun e sigurimit të Jetës kanë shfaqur rënie.
- Totali i Aktivitetit të Tregut të Sigurimeve për periudhën 31.12.2016, sipas pasqyrave financiare është 31.6 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 4 miliardë lekë, ose 14.61% në krahasim me 31.12.2015, periudhë në të cilën ishte 27.6 miliardë lekë. Kjo rritje është reflektuar kryesisht në zërat "Aktive të Tjera" dhe "Debitorë". Në total, të dy zërat, Aktive të Tjera dhe Debitorë për periudhën 31.12.2016, kanë pësuar rritje, përkatësisht në masën 32.31% dhe 36.27%, krahasuar me 31.12.2015.
- Për periudhën 31.12.2016, vihet re një rritje e zërit të Provigjoneve Teknike Bruto për të gjitha shoqëritë. Në nivel tregu, Provigjonet Teknike Bruto janë në vlerën 15.5 miliardë lekë, duke u ulur me 1.55 miliardë lekë, ose me 11.08%, krahasuar me 31.12.2015, që kanë qenë në vlerën 14 miliardë lekë.
- Assets Covering of Technical Provisions Indicator in the insurance market for the period 31.12.2016 is 96.27%, marking a decrease from 106.8% on 31.12.2015. For the period of 31.12.2016, this indicator for the Non-Life insurance market was 95.37%, decreasing from 104.56% at the end of 2015, while for the Life insurance market it was 103.63%, decreasing from 124.18% on 31.12.2015.
- Profitability indicators ROE and ROA for the Non-Life insurance market are respectively 5.08% (from 4.2% at 31.12.2015) and 1.6% (from 1.5% at 31.12.2015). While for the Life market they are at respectively 5.14% (from 13.2% at 31.12.2015) and 2.4% (from 6.1% at 31.12.2015). ROE and ROA indicators have increased compared to 2015 for the Non-Life insurance market, while for the Life insurance market they have declined.
- Total Assets of the Insurance Market for the period 31.12.2016, according to the financial statements is ALL 31.6 billion and has increased to the amount of ALL 4 billion, or 14.61% compared to 31.12.2015, period in which it was ALL 27.6 billion. This increase is mainly reflected in the items "Other Assets" and "Debtors". In total, both items, "Other Assets" and "Debtors" for the period 31.12.2016 increased 32.31% and 36.27% respectively compared to 31.12.2015.
- For the period of 31.12.2016, it was noted an increase of the Item Gross Technical Provisions for all companies. At the market level, the Technical Gross Provisions are in the amount of ALL 15.5 billion, decreasing by ALL 1.55 billion or by 11.08% compared to 31.12. 2015 at ALL 14 billion.



- Rezultati Financiar Neto i tregut të sigurimeve për vitin 2016 është pozitiv, në vlerën 493 milionë lekë, por ka pësuar një rënie prej 136 milionë lekë, ose 21.7%, krahasuar me periudhën 31.12.2015, kur ka qenë 628 milionë lekë. Rezultati financiar neto i tregut të sigurimit të Jetës për 31.12.2016 është pozitiv, në vlerën 77 milionë lekë. Rezultati financiar neto i tregut të sigurimit Jo-Jetë për 31.12.2016 është pozitiv, në vlerën rreth 415.9 milionë lekë.

Tregu i sigurimit Jo-Jetë për vitin 2016 regjistron një Rezultat Teknik Pozitiv, në vlerën 454 milionë lekë, duke u rritur me 418 milionë lekë, krahasuar me 31.12.2015, kur ka qenë në vlerën 35 milionë lekë. Tregu i sigurimit të Jetës në 31.12.2016 ka shënuar rezultat teknik pozitiv në vlerën 111 milionë lekë. Krahasuar me 31.12.2015, rezultati teknik është ulur me 161 milionë lekë, ose me rreth 59%.

- Niveli ende i ulët i Raportit të Primeve të Shkruara Bruto ndaj PBB, në masën 1.04%, vazhdon të përforcojë pritshmërinë se tregu shqiptar i sigurimeve paraqet potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm.


- *The Net Financial Result of the insurance market for 2016 was positive, at the value of ALL 493 million, but it decreased by ALL 136 million or 21.7% compared to the period 31.12.2015, when it was ALL 628 million. The net financial result of the Life insurance market for 31.12.2016 was positive, at the value of ALL 77 million. The net financial result of the Non-Life insurance market for 31.12.2016 was positive, at the value of about ALL 415.9 million.*

*The Non-Life Insurance Market for 2016 records a Positive Technical Result, at the value of ALL 454 million, increasing by ALL 418 million compared to 31.12.2015, when it amounted to ALL 35 million. The Life insurance market on 31.12.2016 marked a positive technical result at ALL 111 million. Compared to 31.12.2015, the technical result decreased by ALL 161 million, or by about 59%.*

- *The low level of the Gross Written Premiums to GDP, at the rate of 1.04%, continues to reinforce the expectation that the Albanian insurance market, presenting great potential for further development.*


### Aktivet në Mbulim të Provigjoneve Teknike për Sigurimin Jo-Jetë

Assets Covering Technical Provisions for Non-Life Insurance



### Aktivet në Mbulim të Provigjoneve Teknike për Sigurimin e Jetës

Assets Covering Technical Provisions for Life Insurance



Gjatë vitit 2016 kanë filluar të përdoren testet e Paralajmërimit të Hershëm (EWT) për tregun e sigurimit Jo-Jetë në Shqipëri. Këta tregues financiarë i shërbejnë evidentimit të problemeve që mund të bëhen shkak për përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg. Ruajtja e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje dhe mbrojtja e konsumatorit janë ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së AMF-së. Veprimet e Autoritetit, me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në këtë drejtim, përfshijnë monitorimin e praktikave të tregut në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërhyrjen me theks të veçantë në ato zona, të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve. Gjatë vitit 2016, rekomandimet që AMF ka dhënë, lidhen kryesisht me:


- Administrimin e rreziqeve të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- Përshtatjen dhe ristrukturimin e aktiveve të shoqërive në drejtim të rritjes së aktiveve likuide që shërbejnë drejtpërdrejt për mbulimin e provigjoneve teknike;
- Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve, si edhe zbatimin e kërkesave ligjore në drejtim të provigjonimit të dëmeve në proces gjyqësor, për një pasqyrim sa më të drejtë të nivelit të rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë;
- Rënien e mjaftueshmërisë së kapitalit të disa shoqërive nën nivelin e kufirit minimal të përcaktuar ligjërisht, sipas dispozitave të nenit 80 të Ligjit 52/2014;
- Raportimin në Autoritet të informacionit të kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi;
- Plotësimin e kërkesave të Bordit të AMF-së në lidhje me pasqyrimin e saktë në pasqyrat financiare dhe shlyerjen e detyrimeve që lidhen me dëmet e Fondit të Kompensimit;
- Mbajtjen në konsideratë dhe reduktimin brenda limiteve maksimale të lejuara të raportit të mbajtjes neto, duke rishqyrtuar politikën e saj të kalimit në risigurim dhe reduktimin e raportit të shpenzimeve brenda limiteve maksimale të lejuara;
- Përmirësimin e politikave dhe procedurave që lidhen me rakordimin e të dhënave ndërmjet departamenteve të ndryshme të shoqërive të sigurimit dhe të informacionit të kërkuar, sipas kërkesave ligjore në fuqi, deri në raportimin përfundimtar të tyre në Autoritet;
- Përmirësimin e standardeve teknologjike në drejtim të sigurisë së sistemeve të informacionit, veçanërisht ato që lidhen me raportimin *onlin* e në Autoritet, të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe të dëmeve që rrjedhin nga këto polica.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përbushjen e kërkesës ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Fondi i Garancisë është investuar në “Depozita Qëllimore” në banka të nivelit të dytë dhe Bono Thesari, sipas kërkesave të ligjit.

*Early Warning Tests (EWT) started to be used for the Non-Life Insurance Market in Albania during 2016. These financial indicators serve to identify problems that may be due to the deterioration of one or more parameters of market operators. Maintaining the stability of financial markets under supervision and consumer protection is among the main objectives of AFSA's activity. The actions of the Authority, in order to prevent and eliminate violations in this regard, include monitoring of ongoing market practices and interference with particular emphasis in those areas that are exposed to high risk or towards the protection of consumers' interests. During 2016, the recommendations that AFSA provided mainly relate to:*

- *Management of risks contracted by the insurance companies, in accordance with applicable legal requirements;*
- *Adaptation and restructuring of company assets in terms of increasing assets liquidity serving directly for covering technical provisions;*
- *Evaluation and processing of claims, as well as the implementation of legal requirements in terms of provision of claims in litigation process, for a more fair reflection of the risk level contracted by companies;*
- *The decline of the capital adequacy of some companies below the minimum legally defined level, according to the provisions of Article 80 of Law 52/2014;*
- *Reporting to the Authority of the information required by the applicable legal requirements;*
- *Meeting the demands of AFSA Board in connection with disclosure of accurate financial statements and settlement of liabilities related to the claims of the Compensation Fund;*
- *Taking into consideration and reduction within the allowed maximum limits of the net retention ratio by reviewing its reinsurance transition policies and reducing the expenditure ratio within the maximum allowed limits;*
- *Improving policies and procedures related to reconciliation of data between different departments of insurance companies and required information, according to the legal requirements in force, until their final reporting to the Authority;*
- *Improving technological standards in terms of security of information systems, especially those related to online reporting to the Authority, sales of compulsory motor insurance policies and claims arising from these policies.*

*The AFSA has consistently pursued the fulfilment of the legal requirement on the Guarantee Fund of Insurance Companies and the implementation of the rules for its investment. The Guarantee Fund is invested in “Target Deposits” in the second level banks and Treasury Bills, as required by law.*



### III. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

#### 1. Struktura e tregut të pensioneve private vullnetare

Struktura e tregut të pensioneve private vullnetare përbëhet nga tre shoqëri administruese, një nga të cilat administrojnë një fond pensioni vullnetar dhe dy fonde investimi. Dy shoqëritë e tjera administrojnë nga një fond pensioni vullnetar.

- Shoqëria administruese e Fondeve të Pensionit dhe SIK Raiffeisen Invest sh.a. administrojnë një fond pensioni i cili është Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 107, datë 18.10.2010 dhe dy fonde investimi, të cilët janë Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 180, datë 13.12.2011 dhe Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 135, datë 26.09.2012.
- Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryen Banka e Parë e Investimeve, e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me Vendimin e Bordit nr. 80, datë 30.08.2010.
- Shoqëria administruese e fondeve të pensionit Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a. është licencuar si e tillë me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 50, datë 30.03.2011. Kjo shoqëri aktualisht administrojnë vetëm një fond pensioni, i cili është Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 51, datë 30.03.2011.
- Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryen Tirana Bank, e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me Vendimin e Bordit nr. 114, datë 18.11.2010.
- Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit dhe SIK Credins Invest sh.a. është licencuar fillimisht si shoqëri administruese e fondeve të pensionit e njohur nën emrin SiCRED sh.a. me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 156, datë 23.11.2011. Nëpërmjet Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 85, datë 30.05.2016 u miratua licencimi i kësaj shoqërie për të kryer edhe veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive nën emrin e ri Credins Invest sh.a.
- Kjo shoqëri aktualisht administrojnë fondin e pensionit vullnetar Siced Pensions, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 173, datë 13.12.2011 dhe fondin e investimit Credins Premium, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 86, datë 30.05.2016. Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryejnë Tirana Bank dhe Banka e Parë e Investimeve.

### III. Report on the Financial Situation of the Voluntary Private Pension Market

#### 1. Structure of voluntary private pension market

The structure of the voluntary private pension market consists of three Management Companies, one of which manages a voluntary pension fund and two investment funds. The other two companies manage a voluntary pension fund.

- The Pension Fund Management Company and SIK Raiffeisen Invest sh.a. manages a pension fund which is the Raiffeisen Voluntary Pension Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 107, dated 18.10.2010 and two investment funds, which are the Raiffeisen Prestige Investment Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 180, dated 13.12.2011 and the Raiffeisen Invest Euro Investment Fund approved by the AFSA Board Decision no. 135, dated 26.09.2012.
- For this company, the depository function is performed by the First Investment Bank, which was licensed by the AFSA to perform the depository function with Board Decision no. 80, dated 30.08.2010.
- The Pension Fund Management Company Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a. was licensed as such by the AFSA Board Decision. 50, dated 30.03.2011. This company currently manages only one pension fund, which is the Sigal Voluntary Pension Fund, approved by the AFSA Board Decision No. 51, dated 30.03.2011.
- For this company, the depository function is performed by Tirana Bank, which was licensed by the AFSA to perform the depository function with Board Decision no. 114, dated 18.11.2010.
- The Pension Fund Management Company and SIK Credins Invest sh.a. was initially licensed as a pension fund management company under the name SiCRED sh.a. with AFSA Board Decision no. 156, dated 23.11.2011. Through the AFSA Board Decision no. 85, dated 30.05.2016, it was approved the licensing of this company in order to perform asset management activities of collective investment undertakings under the new name Credins Invest sh.a.
- This company currently manages Siced Pensions Voluntary Pension Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 173, dated 13.12.2011 and investment fund Credins Premium, approved by the AFSA Board Decision no. 86, dated 30.05.2016. For this company, the function of the depository is performed by Tirana Bank and the First Investment Bank.

## 2. Mbiqëqyrja e tregut të pensioneve private vullnetare

Mbiqëqyrja e Tregut të pensioneve private vullnetare ushtrohet nga AMF mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare", ndryshuar me Ligjin 54/2014, si dhe Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Qëllimi i ligjit për fondet e pensionit vullnetar është të vendosë standardet e nevojshme për:

- Administrimin me efektivitet të fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e kontributeve të bëra në fondin e pensionit;
- Mbiqëqyrjen e biznesit të fondit të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit;
- Nxitjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aseteve të fondit të pensionit;
- Licencimin dhe mbiqëqyrjen e shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe planit të pensionit profesional, të depozitarit të aseteve të fondeve të pensionit dhe të tëgjitha çështjeve të lidhura me to.

Gjatë vitit 2016, u hartua dhe filloi zbatimi i një metodologjie të re mbiqëqyrëse, ajo me bazë rreziku për fondet e pensioneve vullnetare. Nëpërmjet kësaj metodologjie evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm.

Kjo metodologji, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili ka filluar aktivitetin e tij gjatë këtij viti me miratimin e metodologjisë së re mbiqëqyrëse.

Në kuadrin e kësaj metodologjie të re mbiqëqyrëse me bazë rreziku, gjatë vitit 2016, AMF me asistencën teknike të konsulentëve të Bankës Botërore kreu inspektim pilot pranë një prej shoqërive që administron një fond pensioni. Inspektimi me metodologjinë me bazë rreziku u mbështet në parimet e qeverisjes së mirë të shoqërisë dhe të menaxhimit të rrezikut si elementë kryesorë të kësaj metodologjie të re mbiqëqyrëse.

Ky proces do të zbatohet për të gjitha shoqëritë administruese të fondeve të pensionit, duke krijuar kështu një bazë të dhënash në nivel tregu, e cila ndihmon në vlerësimin e rrezikut të secilës shoqëri administruese.

Gjithashtu, në fund të vitit 2016, nisi puna për zbatimin e programit të inspektimit në vend me bazë rreziku pranë njësisë së depozitarit të dy prej fondeve të pensionit, punë e cila do të vijojë edhe gjatë vitit 2017.

## 2. Voluntary private pension market supervision

The AFSA supervision of voluntary private pension market is based on the Law no. 9572, dated 03.07.2006 "On the Financial Supervisory Authority", amended by Law 54/2014 and Law no. 10197, dated 10.12.2009 "On voluntary pension funds", and by-laws approved in regard to its implementation. The purpose of the law on voluntary pension funds is to establish the necessary standards for:

- Effective management of voluntary pension funds, through diversification of investments, with the aim of increasing the contributions made to the pension fund;
- Supervision of the voluntary pension funds with defined contributions, in order to ensure the protection of pension fund members;
- Promotion of stability, security and good governance of pension fund assets;
- Licensing and supervision of pension fund Management Company and professional pension scheme, depository of pension fund assets and all related issues.


During 2016, a new supervisory methodology was drafted and developed, and it began with a risk-based approach to voluntary pension funds. This methodology identifies the greatest risks affecting this market and, at the same time, the strategies to be followed for their mitigation at an acceptable level.

This methodology, in order to develop a sound process in consideration of risk assessment, has also anticipated the establishment of the Risk Committee for Pension Funds, which started its activity this year with the adoption of a new supervisory methodology.

In the framework of this new risk-based supervisory methodology, during 2016, the AFSA with technical assistance from World Bank consultants conducted a pilot inspection at one of the companies managing a pension fund. The risk-based methodology inspection was based on the principles of good corporate governance and risk management as key elements of this new supervisory methodology.

This process will apply to all pension fund management companies, thus creating a market-level database that helps to assess the risk of each management company.

In addition, at the end of 2016, work started on the implementation of the on-site risk-based inspection program at the depository unit of both pension funds, which will continue in 2017 as well.



### 3. Treguesit teknikë e financiarë të shoqërive administruese dhe фондеве të pensioneve vullnetare 31.12.2016

Tregu i pensioneve shfaqet më modest në krahasim me dy tregjet e tjera. Megjithatë, ky treg ka shfaqur një dinamikë më të lartë rritjeje, veçanërisht në lidhje me numrin e anëtarëve. Në 2016, totali i aseteve neto të фондеве të pensioneve private u rrit me 41.99% krahasuar me vitin 2015 (në 2015 rritja ishte 47.62%), dhe numri i anëtarëve me 37.89% në krahasim me vitin 2015 (në 2015 rritja ishte 47.91%).

Zhvillim i rëndësishëm në këtë treg ishte përfshirja e nxitësve të përshtatshëm fiskalë në paketën fiskale të vitit 2015. Kështu, në paketën fiskale të vitit 2015 (parashikuar nga Ligji nr. 156/2014), kontributet e punëdhënësit dhe punëmarrësit në skemat e фондеве të pensionit njihen si të ardhura të patatueshme, deri në kufijtë e përcaktuar nga ligji dhe pasqyrohen në listëpagesat.)

Totali i aktiveve të shoqërive administruese të фондеве të pensioneve (SHAFP) në 31.12.2016 është 390,481,426 lekë. Në total tregu, 14.11% e aktiveve të SHAFP janë investuar në Obligacione qeveritare të R.SH., dhe 56.55% në Llogari rrjedhëse dhe Depozita.

Gjatë vitit 2016, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre фонде pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.12.2016 tregon një total të aktiveve neto prej 1,318.74 milionë lekë, me një rritje prej afro 389.99 milionë lekë ose 41.99% krahasuar me fundin e vitit 2015. Shoqëria "Sigal-Life Pension" sh.a. administron 51.01% të aktiveve neto të tregut, shoqëria administruese "Raiffeisen Invest" sh.a. administron 31.26% të këtyre aktiveve neto, ndërsa 17.73% administrohen nga shoqëria "Credins Invest" sh.a.

